


Diskriminimi ndaj shqiptarëve fillon qysh në çerdhe

-
*Pabarazitë në qasjen në edukim
parashkollor në Maqedoninë e Veriut*



Përmbajtja

Hyrje	3
Pasqyra e përgjithshme e çerdheve dhe qendrave për zhvillim të hershëm fëmijëror	4
Struktura e të punësuarve Numri i fëmijëve sipas llojit të institucionit	4
Numri i fëmijëve sipas llojit të institucionit	4
Struktura gjuhësore e çerdheve	5
Konkluzione	6

Hyrje

Dëshmitë shkencore tregojnë se investimi në edukim parashkollor sjell përfitime afatgjata si për fëmijët ashtu edhe për shoqërinë në tërësi.

Në rrafshin personal, edukimi i hershëm ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, si në planin afatshkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë. Fëmijët që marrin pjesë në edukim parashkollor cilësor kanë rezultate më të mira kognitive, shoqërore dhe emocionale. Për më tepër, edukimi i hershëm fëmijëror është i lidhur me arritje më të larta arsimore dhe rezultate më të mira shëndetësore.

Në nivelin shoqëror, edukimi parashkollor është jetik për të rritur kapitalin njerëzor të një vendi, për të reduktuar pabarazitë, përfshirë atë gjinore duke u mundësuar nënave rikthim të shpejtë në tregun e punës, si dhe për rritje të gjithëmbarshme ekonomike.

Andaj, duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit të hershëm fëmijëror, Bashkimi Evropian (BE), në objektivat e tij arsimore synon pjesëmarrjen e 95% të fëmijëve në edukimin parashkollor deri në vitin 2030.

Në Maqedoninë e Veriut, përfshirja në edukim parashkollor ngelet e mangët dhe larg standardeve të BE-së. Sipas [raportit të progresit 2022](#) për Maqedoninë e Veriut, vetëm 45% e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç ishin të regjistruar në çerdhe dhe qendra publike për zhvillim të hershëm fëmijëror në vitet 2020-2021.

Veç kësaj, qasja në edukim parashkollor në Maqedoninë e Veriut historikisht ka qenë thellësisht jobarazitare, veçanërisht në rrafshin social dhe atë komunitar:

- ◆ Sipas UNESCO-s dhe [databazës së saj botërore për pabarazinë arsimore](#), në vitin 2011 (viti i fundit për të cilin ekzistojnë këto të dhëna), fëmijët e moshës 3-4 vjeç që i takonin 20 përqindëshit më të varfër nuk merrnin fare pjesë në edukim parashkollor (0%), ndërsa ata që i takonin 20 përqindëshit më të pasur merrnin pjesë në shkallë prej 56%. Në rrafshin komunitar, vetëm 3% e fëmijëve shqiptarë të moshës 3-4 vjeç merrnin pjesë në edukim parashkollor, krahasuar me 37% për ata maqedonas.
- ◆ Sipas bazës së të dhënave [Makstat](#), në vitin 2018 fëmijët e regjistruar në çerdhe dhe qendra për zhvillim të hershëm fëmijëror shpëndareshin si vijon sipas përkatësisë së deklaruar kombëtare apo etnike : maqedonët 86%, shqiptarët 8,5%, turqit 1,5%, romët 1,9%, vlllehët 0,2%, serbët 0,7%, boshnjakët 0,6 dhe të tjerët 0,5%.

Por si ka evoluar numri i fëmijëve shqiptarë të përfshirë në edukim parashkollor gjatë viteve të fundit dhe cila është gjendja sot sa i përket pabarazisë komunitare?

Për të vlerësuar gjendjen e tanishme, Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi ka analizuar statistikat e vitit 2022 për çerdhet dhe qendrat për zhvillim të hershëm fëmijëror në Maqedoninë e Veriut, të publikuara më 19 prill 2023 nga [Enti Shtetëror i Statistikës](#).

Pasqyra e përgjithshme e çerdheve dhe qendrave për zhvillim të hershëm fëmijëror

Në nivel vendi, janë gjithsej 113 institucione për edukim parashkollor, të cilat ndahen si vijon sipas llojit të institucionit:

- ◆ 73 çerdhe publike
- ◆ 32 çerdhe private
- ◆ 4 çerdhe fëmijësh në shkolla private
- ◆ 2 qendra publike për zhvillim të hershëm fëmijëror
- ◆ 1 qendër private për zhvillim të hershëm fëmijëror
- ◆ 1 çerdhe publike për nevojat e të punësuarve

Pra, gjithsej në nivel vendi janë 76 institucione parashkollore publike dhe 37 të tilla private.

Struktura e të punësuarve Numri i fëmijëve sipas llojit të institucionit

Sistemi parashkollor është një punëdhënës i rëndësishëm pasi që janë gjithsej 5.581 të punësuar në institucionet e tilla.

Ndër ta, 5.229 apo 95,94% janë të punësuar në sektorin publik, dhe 352 apo 4,06% në sektorin privat. Gratë përbëjnë 92,53% e personelit të punësuar në sistemin parashkollor. Personeli kujdesor përbën 38,15% të personelit total, ndërsa personeli pedagogjik 25,82%.

Numri i fëmijëve sipas llojit të institucionit

Numri i përgjithshëm i fëmijëve në sistemin parashkollor është 35.932, të ndarë si vijon sipas llojit të institucionit :

- ◆ Çerdhe publike : 34.356 fëmijë apo 95,61%
- ◆ Çerdhe private : 1266 fëmijë apo 3,52%
- ◆ Çerdhe në shkolla private : 177 fëmijë apo 0,49%

- ◆ Qendra publike për zhvillim të hershëm fëmijëror : 67 fëmijë apo 0,19%
- ◆ Qendra private për zhvillim të hershëm fëmijëror : 15 fëmijë apo 0,04%
- ◆ Çerdhe publike për nevojat e të punësuarve : 51 fëmijë apo 0,14%

Pra, 95,95% e fëmijëve vijnë në edukimin parashkollor në struktura publike, krahasuar me vetëm 4,05% në institucione private, gjë që konfirmon rolin jetik të shtetit në këtë fushë.

Struktura gjuhësore e çerdheve

Struktura gjuhësore e fëmijëve që vijnë në edukimin parashkollor, sipas gjuhës në të cilën zhvillohet veprimtaria është si vijon :

- ◆ Maqedonisht : 31.420 fëmijë apo 87,44% e totalit
- ◆ Shqip : 3.369 fëmijë apo 9,38%
- ◆ Turqisht : 165 apo 0,46%
- ◆ Boshnjakisht : 8 apo 0,02%
- ◆ Anglisht : 162 apo 0,45%
- ◆ Veprimtari shumëgjuhësore : 808 apo 2,25%

Nuk ekzistojnë të dhëna për komunitetet tjera gjuhësore siç janë romët, vllahët dhe serbët, përpos atyre të vitit 2018 të përmendura më sipër.

Nëse kryqëzohen këto të dhëna me shifrat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2021, del se fëmijët shqiptarë janë skajshmërisht të diskriminuar krahasuar me ata maqedonas:

- ◆ Ndërsa maqedonasët janë 57.86% e popullsisë së përgjithshme, vendet në institucione parashkollore në gjuhën maqedone përbëjnë 87.44% të totalit;
- ◆ Shqiptarët që janë 31,51% e popullsisë së përgjithshme, disponojnë me vetëm 9.38% të vendeve në institucione parashkollore në gjuhën e tyre.

Për të arritur nivelin e vendeve në dispozicion në gjuhën maqedone, në përputhje me strukturën kombëtare të popullsisë së vendit, duhet të krijohen hiç më pak se 13.742 vende të reja në gjuhën shqipe, apo një rritje prej 407% krahasuar me gjendjen aktuale.

Thënë ndryshe, nevojat e familjeve shqiptare për vende në institucione parashkollore përmbushën me vetëm 25% krahasuar me ato maqedone. Pra, një fëmijë shqiptarë i lindur sot në Maqedoninë e Veriut, ka katërfish më pak shanca që të gjejë një vend në çerdhe në gjuhën e tij amtare krahasuar me një fëmijë maqedonas.

Konkluzione

Të gjithë fëmijët në Maqedoninë e Veriut kanë të drejtë të ndjekin programe për edukim parashkollor. Normat e frekuentimit të fëmijëve janë përgjithësisht të ulëta, me vetëm rreth 45% e fëmijëve të moshës 3-6 vjeç të regjistruar në institucionet për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve.

Problemi më i madh megjithatë është fakti se edukimi parashkollor është thellësisht jobarazitar dhe i segreguar në rrafshin social dhe atë komunitar.

Fëmijët shqiptarë janë thellësisht të diskriminuar dhe kanë katërfish më pak shanca që të gjejnë një vend në çerdhe në gjuhën e tyre amtare krahasuar me fëmijët maqedonas, të cilët janë tejet të privilegjuar karshi të gjitha komuniteteve tjera.

Ky diskriminim është strukturor dhe ndërlidhet me shpërndarjen e padrejtë të resurseve publike dhe me mungesën e institucioneve në vendbanimet ku jetojnë shqiptarët. Segregacioni në edukim parashkollor ka pasoja të shumta në rrafshin individual dhe atë shoqëror, duke trashëguar rrethin vicioz të pabarazisë.

Për t'u adresuar karakteri segregacionist dhe diskriminues i politikës së edukimit parashkollor në Maqedoninë e Veriut nevojitet :

- ◆ Adresimi i menjëhershëm i karakterit segregacionist në vija kombëtare dhe sociale të infrastrukturës së edukimit parashkollor, duke i dhënë prioritet katërfishimit të institucioneve që veprojnë në gjuhën shqipe dhe rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve nga komunitetet tjera jo maqedone dhe atyre nga familjet e varfra.
- ◆ Rritje urgjente dhe substanciale e investimeve në ndërtimin e kapaciteteve të reja në çerdhe dhe qendra për zhvillim të hershëm fëmijëror, për të mbyllur hendekun e frekuentimit i cili momentalisht është rreth 45%, shumë larg caktimit evropian që synon pjesëmarrjen e 95% të fëmijëve në edukimin parashkollor deri në vitin 2030.
- ◆ Përmirësimi i cilësisë së edukimit parashkollor, duke u fokusuar në mbështetjen e aftësisë dhe zhvillimit profesional të personelit të punësuar në institucione parashkollore.

Diskriminimi ndaj shqiptarëve fillon qysh në çerdhe

-

Pabarazitë në qasjen në arsimim dhe zhvillim të hershëm fëmijëror në Maqedoninë e Veriut

Prill 2023

Tel: +389 2 522 2922

E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org

Web: www.ipp-arbenxhaferi.org

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi

Rruga Dame Gruev 7/8/3

1000 Shkup

Maqedonia e Veriut